

VENDIM
Nr. 193, datë 6.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 244, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE TË SHTETIT, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË KOMUNËS KUTALLI TË QARKUT TË BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 244, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në listën e inventarit që i bashkëlidhet vendimit, hiqen pronat e paluajtshme publike të tipit, pyje dhe kullota, me numrat rendorë: 1362, 1363, 1364.
 - b) Në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur vendimit, shtohen pronat e paluajtshme publike, të tipit, pyje dhe kullota, me numrat rendorë 1361 dhe 1365, në pronësi, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 182, datë 13.2.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kutalli të qarkut të Beratit”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kutalli e qarkut të Beratit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha